



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:144963
Datë: 24.04.2024
Numri i dokumentit: 05616325

PA1.nr.52/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Abdullah Ahmeti kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me praktikanten Gjyqësore Gentijana Manaj-Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit, N.H, nga fsh ..., Komuna e Istogut, për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1 nën par 1.12 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, N.H av. D.K, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Dega në Skenderaj, P.nr.46/2022 datë 03.11.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me 22.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit N.H av. D.K, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Dega në Skenderaj, P.nr.46/2022 datë 03.11.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë- Dega në Skenderaj, me aktgjykimin P.nr.46/2022 datë 03.11.2022 të akuzuarin, N.H e ka shpall fajtorë për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1 nën par 1.12 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe e ka dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) viteve, i cili dënim me burgim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës së verifikimit prej katër (4) viteve nga dita kur aktgjykimi të marrë formën e prerë, nuk kryen vepër tjetër penale dhe dënim me gjobë në shumën prej njëmijë e pesëqind (1,500.00) Euro, të cilën shumë është i obliguar që ta paguajë në afat prej nëntëdhjetë (90) ditëve prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Të akuzuarit në bazë të nenit 83 të KPRK-së në dënimin e shqiptuar me gjobë i llogaritet edhe koha e kaluar nën masën

paraburgimit nga data 24.04.2013 deri më datë 31.05.2013. Nëse i akuzuari dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e përcaktuar nga gjykata, atëherë dënimin e shqiptuar me gjobë në bazë të nenit 46 par.3 të KPRK-së do ta zëvendësojë me dënim me burgim, ashtu që një (1) ditë burgim do të llogaritet me njëzetë (20.00) Euro gjobë.

Obligohet i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20.00 € (njëzetë euro), si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 30.00 € (tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Pala e dëmtuar D.M, me adresë ..., Fushë Kosovë (pronar i subjektit afarist "..."), për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullte civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka parashtruar mbrojtësi i të akuzuarit, N.H av. D.K, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit për dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë ashtu që të akuzuarin ta liroj nga akuza apo ta anuloj aktgjykimin dhe çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

Prokuroria e Apelit, me parashtrësën PPA/II.nr.94/2023, datë 20.01.2023, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, konstatoi se:

-Ankesa është e pa bazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit N.H av. D.K, me ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe ligjit penal ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe atë me shkelje absolute të cilat kanë të bëjnë me parregullsitë formale të aktgjykimit. Kur e themi këtë kemi parasysh se aktgjykimi i atakuar nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 të KPPK-së, pasi që ky aktgjykim ka kundërthënë në mes të dispozitivit dhe arsytimit. Dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kundërthënës me brendinë e saj ose me arsyet e aktgjykimit të cilat arsye në masë të madhe janë kundërthënëse. Gjykata nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata e shkallës së parë fare nuk ka vërtetuar arsyet në të cilat është bazuar kur ka vërtetuar ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të mbrojturit të tij. Nëse kemi parasysh periudhën prej 13.04.2013 deri më datë 24.04.2013 janë gjithsej 11 ditë, ndërsa në dispozitiv përshkruhen gjoja pesë raste të vjedhjes së naftës, por nuk përshkruhen asnjë veprim konkret se në cilën datë ka ndodhur, në atë datë cili ka qenë veprimi i të mbrojturit të tij e cili veprimi i të pandehurit SH e cili veprim i të pandehurit V? Pra, një dispozitiv i tillë nuk mund të

qëndroj edhe nga fakti se po të lexohet dispozitivi thuhet: "me ç rast tani të pandehurit paskan shkuar dhe kanë hapur kapakun e pompës dhe në siguresat e pompës kanë vendosur një copë druri të punuar enkas për këtë qellim "kunjë" për të ndalur matjen e ecjes së litrave të derivateve dhe me këto veprime." duke mos u përshkruar se cilin veprim e ndërmerr i mbrojturi tij e cilin veprim i pandehuri SH! Po ashtu nuk përshkruhen se me çfarë veprimi i kanë transportuar këtë naftë që pretendohet se gjoja është vjedhur, duke pasur parasysh se me asnjë provë materiale nuk është vërtetuar se është marrë me automjetin që është gjendur natën kritike dhe nuk është vërtetuar se ky automjet a ka kapacitet që të zëj në rezervar të saj apo në rezervarin që thuhet se është i improvizuar sasinë në njërin rast prej 600 litra që është një sasi që është jashtëzakonisht e vështirë të transportohet. Gjithashtu në këtë dispozitiv përshkruhet se çdoherë i ka marrë i pandehuri V nga 70 euro për secilin shërbim, por nuk përshkruhet se nga kush I ka pranuar këto të holla, si i ka pranuar, e po ashtu nuk është vërtetuar as natën kritike se i ka pranuar këto të holla. Sepse po të kishte pranuar këto të holla edhe natën kritike, kjo gjë ka mundur shumë lehtë të vërtetohet me rastin e kontrollit në trupin e tij se a i ka në gjepin e tij 70 euro që pretendohet se i ka marrë për secilin shërbim. Sipas përshkrimit të dispozitivit të aktgjykimit thuhet: "I pandehuri V ka bërë roje, ndërsa sipas marrëveshjes me të pandehurin N i ka marrë nga 70 euro për secilin shërbim" atëherë i bie se edhe natën kritike i ka marrë 70 euro për shërbimin e tij. Po ti kishte marrë, kjo është dashur të vërtetohet nga zyrtarët policor në vendin e ngjarjes. Tutje vazhdon se aktgjykimi është marrë edhe me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi që gjykata e shkallës së parë nuk është dashur të bëjë aprovimin e pranimit të fajësisë për të bashkë pandehurin pa u vërtetuar saktë veprimet e dy të pandehurve që kanë qenë në bashkëkryerje. Po ashtu gjykata e shkallës së parë ka gabuar kur ka shpallur aktgjykimin e veçantë për të pandehurin tjetër, ndërsa aktgjykim tjetër për të mbrojturin e tij duke pasur parasysh faktin se kemi të bëjmë me bashkëkryerje dhe është dashur që në të njëjtën procedurë të shpall një aktgjykim për të dy të pandehurit edhe pse i pandehuri tjetër e ka pranuar fajësinë më herët. Gjithashtu të pandehurit N.H nuk i janë dorëzuar provat materiale në këtë çështje penale, e që i njëjti gjithashtu nuk ka pasur as mbrojtës në procedurë, e që prokuroria e shtetit nuk i ka plotësuar obligimin e saj për ta pajisur me shkresat e lëndës të mbrojturin e tij. Kjo mund të vërtetohet edhe nga procesverbali ku sigurisht nuk ka një konstatim se prokuroria e shtetit e ka plotësuar obligimin e saj ligjor për ta pajisur me shkresat e lëndës të pandehurin N.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit nuk janë të bazuara. Aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara me ankesë, si dhe as shkelje tjera të procedurës, të cilat kjo gjykatë i vëren çdo herë sipas detyrës zyrtare konform dispozitës së nenit 394 të KPPRK-së, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. Aktgjykimi i ankimuar është konkret dhe i qartë, në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar gjykata e shkallës së parë ka përshkruar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar. Gjukata e shkallës së parë provat i ka vlerësuar në pajtim me dispozitat e nenit 360 par. 2 të KPPK-së, kurse për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 369 par. 6 dhe 7 të KPPK-së, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i merr si të provuara ose të pa provuara. Ajo ka dhënë arsye në të cilat është bazuar me rastin e zgjedhjes së çështjes juridiko penale, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të përgjegjësisë penale të akuzuarit. Në arsyetimin e aktgjykimit përkitazi me ngjarjen e kryerjes së veprave penale në fjalë, janë dhënë arsye të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj

çështje juridike penale, të cilat si të drejta i aprovon edhe kjo gjykatë dhe nuk e sheh të nevojshme të bëjë edhe njëherë vlerësimin për këtë. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë edhe mbrojtjen e të akuzuarit, kështu që përfundimet e gjykatës së shkallës së parë sa i takon mbrojtjes së tij, sipas vlerësimit të kësaj gjykate janë të drejta dhe të bazuara në ligj. Sa i përket pretendimit të mbrojtësit se gjykata e shkallës së parë nuk është dashur të bëjë aprovimin e pranimin të fajësisë për të bashkë pandehurin pa u vërtetuar saktë veprimet e dy të pandehurve që kanë qenë në bashkëkryerje, si i dhe se gjykata e shkallës së parë ka gabuar kur ka shpallur aktgjykimin e veçantë për të pandehurin tjetër, ndërsa aktgjykim tjetër për të mbrojturin e tij duke pasur parasysh faktin se kemi të bëjmë me bashkëkryerje dhe është dashur që në të njëjtën procedurë të shpall një aktgjykim për të dy të pandehurit edhe pse i pandehuri tjetër e ka pranuar fajësinë më herët, nuk qëndrojnë pasi gjykata e shkallës së parë ka zbatuar drejt dispozitat nga neni 322 par. 5 ku citohet se “ gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e shtynë shqiptimin e dënimit për të akuzuarit të cilët e pranojnë fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ose veçohet procedura penale për të akuzuarit të cilët kanë pranuar veprën penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit e ka ankimuar aktgjykimin edhe sa i përket vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke theksuar se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike kur ka konstatuar se i mbrojturi tij ka kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë. Gjykata e shkallës së parë nuk e përshkruan asnjë veprim të mbrojturit të tij në dispozitiv të aktgjykim që do të formonin veprën penale të vjedhjes së Rëndë. Pra, përshkruhet që kanë marrë naftë nga pompa e derivateve "P", por me asnjë provë materiale nuk vërtetohet se i mbrojturi tij të ketë hapur kapakun e pompës e këtë nuk e thotë asnjëri nga dëshmitarët. Dëshmitari- zyrtari policor M.A në raportin e tij policor e po ashtu edhe në dëshminë e tij të dhënë në shqyrtimin kryesor të datë. 07.06.2022 thotë se "ndërsa personi që është prezent në sallë N i ka fut duart te pjesa elektronike e ka prek diçka, e ka marrë dorezën e ka futur në mes të derës së kombit duke e mbushur një rezervar të posaçëm për derivate. Pra, cili paska qenë veprimi i të mbrojturit të tij, i bërë në prani të punëtorit të pompës? Është e pakuptimtë të thuhet se ka kryer veprën penale të Vjedhjes së Rëndë me këto veprime të përshkruara: "I ka futur duart te pjesa elektronike dhe ka prekë diçka", tani ky zyrtar policor merrë rolin e ekspertit të makinerisë për të vërtetuar se i mbrojturi tij paska prek diçka në pjesën elektronike, edhe pse thotë se kemi qenë në largësi prej 10 metra, e duke pasur parasysh edhe orën që pretendohet 01:15 pas mesnate, nëse je në një distancë 10 metra larg dhe prapa pompës, si mund të vërtetohen veprimet e të mbrojturit tim dhe ti falet besimi një deklarami të tillë. Përkundër kësaj dëshmie, gjykata në faqen 11 (18) në fund të pasuesit të dytë cekë kësaj: "I akuzuari N kishte manipuluar me pjesën elektronike të pompës duke vendosur një pykë druri afërsisht 10 m të gjatë përmes të cilit matësi i litrave është penguar të punonte". Por pyetemi se kush e thotë këtë? Kush nga dëshmitarët e vërtetoi këtë? Gjithashtu me asnjë provë materiale nuk u vërtetua se çfarë veprimi ka ndërmarrë i mbrojturi tij më datë 13.04.2013 që përmendet në dispozitiv si datë nga e cila ka filluar kryerja e kësaj vepre penale. Gjithashtu nuk u vërtetua se automjeti kombi i kuq që dyshohet se është kryer vepra penale, sa ka mundur të zë derivate? Në rastin konkret, nuk është vërtetuar edhe ndërhyrja në aparatit e derivateve se a ka ndodhur, si ka ndodhur, a ka mundur në këtë mënyrë të bëhet ndalesa e llogaritjes së naftës? Pra, me një ekspertizë nga lëmia

përkatëse, do të vërtetohej me sigurinë më të madhe se a ka pasur ndërhyrje nga i mbrojturi tij, apo ka pasur një defekt në aparat të derivateve ashtu siç është mbrojtur i mbrojturi tij.

Ky kolegji vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e lartcekura ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase sipas shkresave të lëndës vlerëson se edhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje sikurse që pa të drejtë pretendohet në ankesën e ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit. Ngase pas prezantimit të provave personale dhe materiale dhe atë dëshmisë së D.M pronarin e subjektit afarist të pikës së derivateve “P”, dëshmitarët-zyrtarët policor të Policisë së Kosovës, Stacioni Policor në Skenderaj F.K, M.A dhe B.M, provat materiale: Raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes Nr.2013-BF-268 të datës 24.04.2013 së bashku me fotoalbumin prej njëzetë e dy (22) faqesh, punuar nga zyrtari policor i Njësisë së krim-teknikës dhe hetuesi policor M.A nga Policia e Kosovës-Stacioni Policor në Skenderaj, Raportin e hetimeve Nr.2013-BF-268 të datës 24.04.2013 së bashku me fotoalbumin prej njëzetë e dy (22) faqesh punuar nga Policia e Kosovës-Stacioni Policor në Skenderaj, Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve dhe kthimin e saj Nr.2013-BF-268 të datës 24.04.2013 nga Policia e Kosovës-Stacioni Policor në Skenderaj, Kartela e materialeve të artikullit për periudhën kohore 01.01.2013 deri me 30.04.2013 lëshuar nga subjekti afarist “P”, Procesverbali mbi marrjen në pyetje të të akuzuarit-N.A Nr.2013-BF-268 i datës 24.04.2013 dhënë në Policinë e Kosovës-Stacioni Policor në Skenderaj dhe i datës 29.05.2013 dhënë në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëmtuarit-D.M Nr.2013-BF-268 i datës 24.04.2013 dhënë në Policinë e Kosovës-Stacioni Policor në Skenderaj si dhe i datës 19.06.2013 dhënë në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Procesverbali mbi dëgjimin e dëshmitarit-E.M dhënë në Policinë e Kosovës-Stacioni Policor në Skenderaj Nr.2013-BF-268 të datës 11.05.2013, Faturat tatimore së bashku me kuponët e tyre fiskal të bashkangjitur Numër : 016912, 016913, 016885, 016888, 016893, 016894, 0168910, 015913, 015906, 015909, 16895, 016908, 016911 dhe 016909, që të gjitha lëshuar nga subjekti afarist “P” njësia në Skenderaj dhe, Certifikata e regjistrimit të automjetit-kopje CRA 0389811 me numër të regjistrimit 03-694-DB lëshuar nga Republika e Kosovës. kështu që nga të lartcekurat ky kolegji vlerëson se drejtë ka vepruar gjykata e shkallës së parë se duhet falë besimin këtyre provave, ngase të njëjtat ishin në harmoni me njëra tjetrën nga të cilat përtej çdo dyshimi vërtetohet se i akuzuari ka ndërmarrë veprimet si në përshkrimin faktik të veprës penale të përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit, për çka gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet e saj e të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe ky kolegji, dhe nuk e sheh të arsyeshme të japë edhe njëherë vlerësimin për këtë. Pra nga të gjitha provat e administruara dhe drejtë të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë me të drejtë gjykata e shkallës së parë gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1 nën par 1.12 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për çka me të drejtë e shpalli penalisht përgjegjës dhe fajtor. Një gjendje të tillë faktike si të drejtë dhe të ligjshme e aprovoj edhe Kolegji Penal i kësaj gjykate.

Sa i përket vendimit mbi dënimin mbrojtja pretendon se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, por edhe ka vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë gjendjen faktike, ka marrë edhe vendimin mbi sanksionin penal duke i

shqiptuar të mbrojturit të tij një dënim të gabuar, ngase në mungesë të provave materiale është dashur që i njëjti të lirohet nga aktakuza. Gjithashtu edhe sa i përket llogaritjes së paraburgimit në dënimin me gjobë, nuk është përshkruar se sa i mbetet dënimi me gjobë të mbrojturit të tij. Sepse, nëse i llogaritet paraburgimi në dënim me gjobë, do të duhej të shënoj se sa i ka mbetur dënimi me gjobë të mbrojturit të tij.

Kolegji Penal i Gjykatës së Apelit fillimisht sa i përket pretendimit të mbrojtjes se sa i përket llogaritjes së paraburgimit në dënimin me gjobë, nuk është përshkruar se sa i mbetet dënimi me gjobë të mbrojturit të tij, sepse, nëse i llogaritet paraburgimi në dënim me gjobë, do të duhej të shënoj se sa i ka mbetur dënimi me gjobë të mbrojturit të tij, kolegji vlerësoi se ky pretendim nuk qëndron ngase gjykata e shkallës së parë lidhur me këtë çështje ka vendosur drejtë dhe atë në pajtim me dispozitat e nenit 79 të KPRK e cila dispozitë parasheh se Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim, burgim për të mitur, në masën edukative institucionale dhe dënimin me gjobë, ndërsa llogaritja e saktë e dënimit me gjobë që duhet të paguhet nga i akuzuari bëhet në procedurat tjera ligjore.

Sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me vendimin mbi dënimin Kolegji Penal i Gjykatës së Apelit së apelit vlerëson se edhe për kundër faktit se mbrojtësi i të akuzuarit e ka ankimuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me vendimin mbi dënimin, në përmbajtjen e ankesës nuk ka potencuar ndonjë rrethanë lidhur me këtë bazë ligjore. Lidhur me vendimin mbi dënimin Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, ku si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata mori për bazë rrethanat personale të akuzuarit se i njëjti është familjar i martuar baba i tre fëmijëve, koha e gjatë që nga kryerja e veprës penale, ndërsa si rrethanë rënduese mori shkallën e lartë të dashjes, përgjegjësinë penale si dhe kontributin e tij në kryerjen e veprës penale.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e ankimore, nuk kanë ndikim që të akuzuarit të shqiptojnë një dënim tjetër. Të gjitha këto rrethana, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbejë preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar

është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.52/2023 me 22.03.2024

Procesmbajtëse:
Gentijana Manaj Gashi

Anëtarët e kolegjit:
Skender Çoçaj

Kryetarja e kolegjit:
Abdullah Ahmeti

Zyhdi Haziri